

Interethnic Integration in Education Project

RAPORT MUJOR

i Projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim

shtator 2016

I. AKTIVITETE TË ZBATUARA

Komponenti 1 - Informimi i opinionit dhe bashkësive

- **Janë mbajtur dy ngjarje solemne me prerjen e shiritit.** Në bashkëpunim me shkollat dhe komunat, u realizuan dy ngjarje solemne me prerjen e shiritit me çka u shënuan rinovimet e shkollave të cilat përfunduan me sukses SHF “Aleksandar Zdravkovski”, Komuna e Jegunocit dhe SHF “Drita”, Komuna e Sarajit. Para publikut të shumtë në ngjarje janë prezantuar aktivitetet e nxënësve të cilat u zbatuan me nxënësit e shkollave partnere, me qëllim të ndarjes së praktikave të mira të cilat kontribuojnë për zhvillimin e integrimit ndëretnik.
- **Pjesëmarrje në media.** Përfaqësuesit e PINAs morën pjesë në disa programe të mëngjesit me qëllim që të ndahen rezultatet, aktivitetet dhe progresi i cili ndodh në kuadër të shkollave në drejtim të integrimit ndëretnik. Në TV21 dhe RTVM u fol rreth aktivitetëve të realizuara dhe të ardhshme, si dhe mbështetjen institucionale për aktivitetet për integrimin ndëretnik, ndërsa në TV Telma me opinionin u nda rreth rinovimit dhe mbështetjes së shkollave të goditura nga vërshimet në muajin gusht. Dy prindër të cilët ishin të kyçur në grant programin për involvimin e prindërve në aktivitetet e PINAs ishin mysafirë në programin e mëngjesit të televizionit Alsat-M për të ndarë përvojat dhe praktikat pozitive. Gjithashtu, aktivitetet tjera të prindërve në Veles u mbuluan nga televizioni Kanal 5. Në mënyrë shtesë, u organizua edhe një takim me udhëheqësen e emisionit debatues në TV21 – Klik plus, në të cilin u diskutua rreth mundësisë për pjesëmarrjen e PINA-s në të njëjtin.
- **Forume teatrale.** Në kuadër të këndeve kreative të shkollave SHFS “Orde Çopella” Prilep dhe QSHAK “Boro Petrushevski”, Shkup, nën udhëheqjen e mësimitdhënësve të trajnuar paraprakisht u mbajtën dy forume teatrale. Në forumet teatrale morën pjesë mbi 150 nxënës, mësimitdhënës si edhe mysafirë të tjerë të bashkësive lokale të cilët patën mundësi në mënyrë aktive t’i ndajnë qëndrimet e tyre, të bashkëpunojnë dhe të gjejnë zgjidhje potenciale në skenën e vendosur, me qëllim të thyerjes graduale të paragjykimeve dhe stereotipave dhe përforcimit të bashkëpunimit ndëretnik.
- **Përgatitje për aktivitetet e ardhshme.** U punua në përgatitjen e ngjarjeve solemne të ardhshme të prerjes së shiritit, për ngjarjet promovuese publike, forumet teatrale, prezantimet publike të produkteve të punëtorive kreative, si dhe në akademinë debatuese. Në mënyrë plotësuese, u mbajtën edhe takime koordinuese me organizatat partnere me qëllim të planifikimit të aktivitetëve të ardhshme.
- **Informim i rregullt i institucioneve, komunave dhe shkollave për aktivitetet e PINA.** Një pjesë e aktivitetëve kanë përfshirë edhe azhurnimin e rregullt të informacioneve dhe publikimin e risive dhe tregimeve për rrjedhën e aktivitetëve në faqen e facebook-ut *Integratika*, si dhe në ueb faqen e projektit www.pmio.mk. Gjithashtu, aktivitetet të cilat u zhvilluan në kuadër të shkollave (të pavarura apo në partneritet me shkollat e tjera), gjatë asaj periudhe kishin mbështetje dhe mbulim medial. U përgatit edhe informatori medial dhe u nda me të gjitha shtëpitë mediale në vend.

Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorive të shkollave dhe arsimtarëve

- **Realizimi i aktivitetëve të përbashkëta me përfshirjen e prindërve.** Në kuadër të programit për grante për involvimin e prindërve në INA, u realizuan aktivitetet të përbashkëta të grupeve të përziera etnike të prindërve dhe nxënësve në dy shkollat të cilave iu ndanë grantet. U

Interethnic Integration in Education Project

vizituan aktivitetet e përbashkëta të prindërve me përkatësi të ndryshme etnike në shkollat filllore: “Vëllezërit Milladinov”, Strugë, “Nikolla Karev”, Krushevë, “Mustafa K. Ataturk”, Gostivar, shkollat partnere dhe aktivitete në “Bllagoj Kirkov”, Veles dhe “Rajko Zhinzifov”, f. Orizare, “Hristian T. Karposh”, Kumanovë dhe “7 Marsi”, f. Opajë. Për nevojat e grant programit për involvimin e prindërve në INA u dorëzua edhe pajisje teknike në dy shkolla (SHF “Vëllezërit Milladinov”, Strugë dhe SHF “Hristian T. Karposh”, Kumanovë).

- **Realizimi i ngjarjeve përfundimtare në grant-programin për pjesëmarrjen e prindërve në INA.** Janë organizuar dhe janë vizituar tetë ngjarje përfundimtare në programin për pjesëmarrjen e prindërve në aktivitetet për INA në shkolla të cilët e realizuan këtë grant program. Shkollat partnere “Hristian T. Karposh”, Kumanovë dhe “7 Marsi”, f. Opajë bashkërisht e përgatitën aktivitetin përfundimtar në shkollën në Kumanovë. Janë dërguar edhe pyetësorë për prindërit – pjesëmarrës, si dhe pyetësorë elektronik në shkolla.
- **Pjesëmarrje në Konferencën ndërkombëtare Pedagogjia e shoqërisë globale moderne.** Përfaqësuesit e PINAs morën pjesë në konferencën e organizuar nga Instituti për pedagogji në Shkup, me rastin e jubileut 70-vjeçar të veprimtarisë shkencore-mësimore të Institutit në kuadër të Fakultetit Filozofik.
- **Mbështetje administrative dhe financiare për grantet e vogla.** U sigurua mbështetje për shkollat të cilat janë pjesë e programit për grante të vogla në kuadër të përgatitjes së dokumenteve administrative dhe financiare për pagesë.
- **Realizimi i kampit të dytë veror.** U mbajt kampi i dytë veror i nxënësve në të cilin morën pjesë 42 nxënës të katër shkollave nga Tetova (SHF “Liria”, SHF “Bratstvo Migjeni”, SHF “Aleksandar Cvetkovski” dhe SHF “Shemshovë”), të shoqëruar prej 8 mësimitdhënësve. Në kamp nxënësit patën mundësi të bashkëpunojnë në grupe të përziera përmes realizimit të lojërave për bashkëpunim ekipor dhe aktivitete sportive dhe argëtuese.
- **Takim superviziv me trajnuesit master dhe me mentorët.** Në takim trajnuesve master dhe mentorëve u janë dhënë udhëzime për mbajtjen e takimeve të mentorëve me EISH në drejtim të dhënies së mbështetjes dhe thellimit të kapaciteteve të tyre për zhvillimin e cilësisë së aktiviteteve INA në shkollat e tyre.
- **Fillimi i realizimit të takimeve mentore me EISH të shkollave të të gjitha 3 fazave.** Qëllimi i takimeve të mentorëve është të bëhet shqyrtimi dhe reflektimi për arritjet dhe sfidat e deritanishme nga zbatimi i aktiviteteve të INA në shkolla si dhe t’u jepen udhëzime dhe rekomandime për realizimin e mëtejshëm dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së aktiviteteve INA.
- **Mbahen takime me të gjitha shkollat e gjashtë komunave të përzgjedhura në kuadër të aktivitetit “Ditët e integritimit ndëretnik”.** Qëllimi i takimeve ishte njoftimi i shkollave me konceptin e aktivitetit “Ditët e integritimit ndëretnik” dhe planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta me pjesëmarrjen e të gjitha shkollave në kuadër të komunave të tyre (Butel, Kumanovë, Bërvenicë, Gostivar, Kërçovë dhe Strumicë).

Komponenti 3 - Shkolla modele

- **Trajnim/takime pune me SIT të shkollave modele.** Gjatë muajit u mbajtën tre takime pune në të cilat morën pjesë SIT të katër shkollave modele nga Kumanova, Ohri dhe Kërçova. Në takim janë analizuar rezultatet e vetëvlerësimit të shkollave si dhe rezultatet e vlerësimit të aktiviteteve shkollore nga mësimitdhënësit dhe nxënësit.
- **Përgatitje për ditët për integritim ndëretnik.** Gjatë muajit janë mbajtur katër takime me përfaqësuesit e komunave përgjegjës për arsim dhe drejtorët (koordinatorë të SIT-it) të të gjitha shkollave në kuadër të katër komunave (Kumanova, Gostivari, Kërçova dhe Ohri). Në takime u shpjegua koncepti për organizimin e “Ditëve të integritimit ndëretnik”, si dhe roli i çdo shkolle në ngjarje. Gjithashtu, në Kërçovë dhe në Ohër u mbajtën takime për planifikimin e aktiviteteve me mësimitdhënësit, realizues të aktiviteteve. Shtesë, çdo grup (nga katër në çdo komunë) tashmë realizuan nga një punëtori të përbashkët me grupe të përziera të nxënësve.
- **Shfaqje.** Në fillim të muajit në SHF “Bratstvo Edinstvo” u mbajt një shfaqje me rastin e pritjes së nxënësve të klasës së parë në shkollë. Shfaqja u realizua me pika të integruara me nxënës të të gjitha bashkësive dhe gjuhëve mësimore.

Interethnic Integration in Education Project

Komponenti 4 - Nxjtja e shkollave

- **Kontroll teknik.** Në gjashtë shkolla përfunduan aktivitetet për rinovim, të cilat ishin obligim i PINA. Kontrolli teknik i aktivitetëve u organizua në shkollat në vijim:
 - SHF „Rajko Zhinzifov”, Komuna e Çairit;
 - SHF „Shën Klimenti i Ohrit”, Komuna e Manastirit;
 - SHF „Vëllezërit Milladinov”, f.Dedebalc, Komuna e Mogillës;
 - SHMK „Niko Nestor”, Komuna e Strugës;
 - SHF „Goce Dellçev”, f.Tenovë dhe f.Radiovc, Komuna e Bërvenicës;
 - SHF „Kirili dhe Metodi”, f.Buçin, Komuna e Krushevës.Në këto shkolla kanë përfunduar punimet të cilat janë obligim i shkollës dhe komunave.
- **Pajisje për mirëmbajtjen e objekteve shkollore.** Janë dorëzuar pajisje për mirëmbajtjen e objekteve shkollore në gjashtë shkolla të cilat u rinovuan në vitin 2016.
- **Rinovimi i dy shkollave me mjete të kursyera.** Me kompletimin e tenderëve dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me kompanitë ndërtimore për rinovimin e 13 shkollave në fazën 5 u planifikua buxheti për rinovim dhe është evidentuar se në buxhet ka mjete për rinovimin e dy shkollave shtesë. Ky kursim është bërë si rezultat i mënyrës së zbatimit të furnizimeve publike, konkurrencës midis kompanive dhe çmimeve të ulëta për cilësinë e kërkuar të materialeve dhe punimeve. Janë përzgjedhur shkolla nga lista e pritjes e cila u formua gjatë vlerësimit të aplikacioneve për përzgjedhjen e shkollave në janar të vitit 2016. Dy shkollat shtesë janë:
 - SHF „Hristian Karposh”, Kumanovë dhe
 - SHMK „Mosha Pijade”, Tetovë.Dy shkollat dorëzuan aplikacion për rinovim dhe dokument teknik për projektet prioritare për rinovim.
- **Memorandum për bashkëpunim (MoU).** Memorandumet për bashkëpunim për dy shkollat plotësuese janë nënshkruar nga kryetarët e komunave dhe drejtorët e shkollave, me ç’rast të gjitha palët e involvuara ndërmarrin përgjegjësi në procesin e rinovimit.
- **Tender për përzgjedhjen e zbatuesit më të volitshëm.** Janë përgatitur tenderë për përzgjedhjen e zbatuesit më të volitshëm për rinovimin e dy shkollave, janë dorëzuar kërkesa për oferta dhe janë miratuar kompani për zbatimin e aktivitetëve për rinovim.
- **Vlerësimi i kompanive të para për zbatimin e projektit për rinovimin e dy shkollave plotësuese të fazës 5.** Është organizuar takim për vlerësim me kompanitë e para për zbatimin e projekteve për rinovimin e dy shkollave plotësuese dhe dokumentet e plota për përzgjedhjen e zbatuesit më të volitshëm janë dorëzuar deri te USAID-i për miratim. Lista për kompanitë e përzgjedhura për dy projektet është publikuar në ueb faqen e PINA <http://pmio.mk/category/tender-results/>.
- **Hyrje në punë.** Është organizuar takim për hyrje në punën e kompanive të përzgjedhura zbatuese në prani të përfaqësuesve të PINA, kompanive zbatuese, mbikëqyrësve për zbatim, shkollave dhe komunave. Janë nënshkruar marrëveshje me kompanitë e përzgjedhura për zbatimin e projekteve për rinovimin e dy shkollave plotësuese.
- **Sesione të mentorëve.** Është mbajtur sesion i mentorëve me anëtarët e ERSH në SHMK “Niko Nestor” në Strugë për Modulin 1 – përpunimi i planit dhe buxhetit për rinovimin e shkollave;
- **Takime mujore në 13 shkolla të fazës 4 për ndjekjen e punës për mirëmbajtjen e objekteve shkollore** Të gjitha 13 shkollat e rinovuara në fazën 4 janë vizituar prej personave profesionistë të cilët e ndjekin punën dhe procedurat për mirëmbajtjen e shkollave dhe u është ofruar ndihmë profesionale lidhur me mirëmbajtjen e ndërtesave shkollore (pozita ndërtimore, sisteme të ngrohjeve, instalime elektrike, higjienë).

Monitorimi dhe vlerësimi

- **Hulumtimi elektronik.** U finalizua versioni i punës së raportit të hulumtimit elektronik. Gjithashtu u përgatit aplikacioni elektronik për shkrimin e raportit të grantit për përfshirjen e prindërve.

Interethnic Integration in Education Project

II. AKTIVITET VIJUESE PËR MUAJIN E ARDHSHËM

Komponenti 1 – Informimi i opinionit dhe bashkësive

- Mbajtja e ngjarjeve solemne me prerjen e shiritit;
- Organizimi i prezantimit të forumeve teatrale në shkolla;
- Prezantime publike të produkteve të punëtorive kreative;
- Mbajtja e para-premierës së Doracakut për “40 aktivitete sportive dhe lojëra argëtuese për integrimin e fëmijëve dhe të rinjve”;
- Ngjarje promovuese të Doracakut për “40 aktivitete sportive dhe lojëra argëtuese për integrimin e fëmijëve dhe të rinjve”;
- Organizimi i akademisë debatuuese;
- Azhurnim i rregullt i informacioneve dhe publikimi i risive dhe rrëfimeve gjatë aktiviteteve përmes faqes së Facebook-ut Integratika dhe ueb – faqes së projektit www.pmio.mk.

Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorive të shkollave dhe arsimtarëve

- Mbajtja e ngjarjeve përfundimtare për “Ditët për integrim”;
- Mbajtja e takimeve të mentorëve me EISH të shkollave të të gjitha 3 fazave;
- Rregullim administrativ dhe financiar i procedurës për pagesën e granteve për përfshirjen e prindërve në aktivitetet për INA;
- Realizimi i ngjarjeve promovuese nga komunat për bashkëpunimin e thelluar për INA në bashkëpunim të tyre me shkollat të cilat do t'i prezantojnë arrijtjet në INA;
- Rregullim administrativ dhe financiar i procedurës për pagesën e granteve të vogla.

Komponenti 3 – Shkolla modele

- Mbajtja e Ditëve për integrim ndëretnik në Kumanovë, Gostivar dhe Kërçovë;
- Organizimi i ditëve të hapura në komunën e Ohrit në SHF „Bratstvo Edinstvo”, Ohër dhe SHF „Zhivko Çingo”, f. Vellozhd;
- Mbajtja e punëtorive të përbashkëta me nxënësit e shkollave të ndryshme në komunat Kumanovë, Gostivar, Kërçovë dhe Ohër;
- Distribucioni i materialit promovues – tabllave për brendinë për Shkollat modele.

Komponenti 4 - Nxitja e shkollave

- Fillimi i aktiviteteve për rinovim në dy shkolla;
- Kontroll teknik i objekteve në të cilat do të përfundojnë aktivitetet ndërtimore;
- Trajnim për mirëmbajtjen e objekteve shkollore i dedikuar për personelin teknik dhe sekretarët në shkollat e fazës 5.

Monitorimi dhe vlerësimi

- Prezentimi dhe diskutimi i rezultateve të hulumtimit elektronik para përfaqësuesve të grupit të punës dhe aktivitete të tjera me grupin punues të MASH.